



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.464/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

#### VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.464/2025, e datës 08.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datën 08.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se LDK, Dega në Podujevë ka verejtur se dje në ora 15:04 (brenda orarit të rregullt të punës në Komunën e Podujevës) — Zëdhënsi Patri Zhitija, ka bërë thirrje përmes së cilës ka shkelur nenin 36 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. I njëjti brenda orarit të punës ka postuar në rrjetin e tij social facebook një shkrim, ku shprehimisht thote: "*E verteta e veriut me qeverisjen e Levizjes Vetëvendosjes dhe me qeverisjet e PDK, LDK, AAK*".

Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se për më tepër krahasimin e bërë në foto, ku perfshin edhe subjektin LDK, të cilin e krahason me Aleksander Vuçiq dhe tëë tjetër është shkelja identike e bërë nga kandidati për deputet Dimal Basha, andaj këtu është konsumuar vepra e shkeljes që rrjedh nga neni 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 1. Pra, kemi dy lloj shkelje në një rast, shkelja e nenit 36 paragrafi 2 dhe shkelja e nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 1. Andaj, duke u bazuar në gjithë keto që u thane me lartë dhe provat e bashkangjitura ka kërkuar që të merret vendim meritor për rastin në fjalë, pra të shqiptohet masë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin e shpërndarë në rrjetin social me fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se ankesa është e pabazuar dhe e paqëndrueshme, kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban elemente të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Posti i tillë me fotografitë dhe tekstin përkatës, është fshirë nga Ilogaria e tij personale dhe rrjedhimisht, nuk është aktiv tutje si post dhe lajm. Prandaj konsiderojmë se pretendimet e tilla të parashtruesit kinse janë shkelur dispozita të caktuara zgjedhore janë të paqëndrueshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, Paneli i vlerësoj se janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që nga fotoja e cila është publikuar në rrjetin social ku vërehet deklarata e Fatri Zhitija e të cilat deklarata sipas panelit konsiderohen diskurs që zakonisht përdoret gjatë fushatave zgjedhore, prandaj si të tilla nuk mund të konsiderohen si shkelje të pretenduara nga pala ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, pasi që nuk ka ofruar asnjë provë për vërtetimin e këtyre shkeljeve.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.464/2025 më datën 11.02.2025

**Kryesues i Panelit**  
**Skender Çoçaj**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.